



**VENDIM**

**Nr. 28 Datë 09.03.2016**

**MBI**

**KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË  
ENERGJISË SË RINOVUESHME PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR 13  
DATË 16.02.2016 TË BORDIT TË ERE MBI TARIFËN FIKSE TË  
ENERGJISË , QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe nenit 16 pika 3 të “Rregullave te Praktikes dhe Procedurave të ERE-s”, të miratuar me Vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 09.03.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi ankimin administrativ të Shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme AREA, për vendimin nr. 13, datë 16.02.2016 të Bordit të ERE ,

**Konstatoi:**

- Shoqata AREA nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi të Bordit të ERE.
- Regjistrimi i hetimit gjyqësor për kundërshtimin e një tjetër vendimi të ERE **Nr 156 datë 24.12.2015**, nuk përbën provë të re, që të çojë Bordin e ERE në një vendimmarrje të re.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

### **Vendosi:**

1. Të refuzojë kërkesën e shoqatës shqiptare të energjisë së rinovueshme AREA, për rishikimin e vendimit nr 13 datë 16.02.2016 të Bordit të ERE “Mbi tarifën fikse të energjisë , që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara, për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Petrit AHMETI**